

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	AKSIK- Kryeministria
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozim/ i brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	<p>Vendim i Këshillit të Bashkimit Evropian të 23 shtatorit 2013 “Për rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar” 2013/488/BE, i ndryshuar; Direktiva 2009/81/KE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009 «Mbi koordinimin e procedurave dhe dhënien e kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritetet kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë dhe që ndryshon direktivat 2004/17/KE dhe 2004/18/KE », të ndryshuar.</p> <p>NR.CELEX 32013D0488, “Fletore zyrtare” e Bashkimit Evropian seria L, nr.274, datë15.12.2013, faqe 1-50.</p> <p>https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3AOJ.L_.2013.274.01.0001.01.ENG&toc=OJ%3AL%3A2013%3A274%3ATOC</p> <p>-Direktivën 2009/81/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datë 13 korrik 2009 “Mbi koordinimin e procedurave dhe dhënien e disa kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritetet kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë dhe që ndryshon direktivat 2004/17/KE dhe 2004/18/KE”, të ndryshuar, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian seria L, nr. 216/76, datë 20.08.2009, faqe 1-76.</p> <p>https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:02009L0081-20240101</p>
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	<p>Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Shqipërisë për periudhën 2023-2028;</p> <p>Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025 -2030 dhe Plani i Veprimit për periudhën 2025–2027</p>
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	07.04.2026 - 07.05.2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	06/05/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT?	Po, 04/04/2026

NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – AKSIK- Nr. 1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Adanela Aliaj Adanela.Aliaj@nsa.gov.al +355692460004 Ada Çela Ada.Cela@nsa.gov.al +355672052522

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)

Mbrojtja e informacionit të klasifikuar nga humbja, dëmtimi, rrjedhja, kompromentimi ose ekspozimi i paautorizuar është një nga prioritetet e qeverisë shqiptare. Gjatë zbatimit të ligjit në këtë fushë janë evidentuar disa problematika, që lidhen me mungesën e dispozitave në ligjin aktual që duhet të rregullojnë:

- Kryerjen e inspektimeve në fushën e informacionit të klasifikuar sipas ligjit për inspektimet;
- Procedurat e detajuara për realizimin e trajnimeve me personelin që punon me informacion e klasifikuar;
- Deklasifikimin e informacionit të klasifikuar nga institucionet që nuk kanë “autoritet klasifikues”;
- “Autoritet klasifikues”, për ato raste të veçanta dhe me afat të kufizuar, kur titullari i institucionit nuk mund të ushtrojë të drejtën e klasifikimit të informacionit;
- Rastet kur konstatohet klasifikim i parregullt i informacionit;
- Shkatërrimin emergjent të informacionit të klasifikuar nga Përfaqësitë diplomatike të RSH-së jashtë vendit, në rastet gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore dhe të emergjencave të tjera civile për evakuimin e informacionit të klasifikuar;
- Për shkeljen e rregullave të transportimit fizik të informacionit të klasifikuar.

Këto mangësi rregullatore kanë shkaktuar problematika gjatë punës me informacionin e klasifikuar pasi ligji për inspektimet është rishikuar dhe lind nevoja për të plotësuar kuadrin ligjor të AKSIK. Gjithashtu, duhet plotësuar kuadri ligjor për kryerjen e deklasifikimit nga autoriteti jo klasifikues për të mos krijuar pengesa në proceset e punës, zgjidhjen e problematikës për rastet e veçanta për autoritet klasifikues, të vendosen procedurat e detajuara që duhen ndjekur gjatë trajnimeve, kryerjen e klasifikimit të rregullt duke vendosur edhe afatin e ruajtjes së informacionit të klasifikuar, rastet e shkatërrimit emergjent të informacionit të klasifikuar, si dhe qartësimin e përgjegjësisë për rregullat e transportimit fizik të informacionit të klasifikuar.

Grupet e prekura nga problematikat janë:

- **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK)**, si institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit;
- **Institucionet e administratës publike** (ministrinë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, administratën e prefektit, institucionet e pavarura, gjykatat, prokuroritë e çdo juridiksioni, Byronë Kombëtare të Hetimit, si dhe organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, që prodhojnë, administrojnë ose trajtojnë informacion të klasifikuar, të cilat në ushtrimin e funksioneve të tyre mund të kenë qasje në informacion të klasifikuar;

- **Përfaqësitë diplomatike jashtë vendit**, që preken nga dispozitat për evakuimin/shkatërrimin emergjent;
- **Personat fizikë dhe juridikë** që, për shkak të funksioneve ose detyrave të tyre dhe në përputhje me parimin “nevojë për njohje”, mund të kenë qasje në informacion të klasifikuar;
- **Qyterarët;**
- **Qeveria.**

Për të rregulluar problematikat dhe mangësitë e identifikuara nevojitet ndërhyrja e qeverisë, në funksion të rritjes së standardeve të sigurisë, si dhe integritit të termave të përcaktuara në Dokumentin e Politikës së Sigurisë të NATO-s dhe politikën e BE-së për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Objektivat e politikës, që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij janë:

1. Qartësimi i kompetencave për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar, për institucionet që prodhojnë informacion të klasifikuar brenda vitit 2026;
2. Përmirësimi i mekanizmave për korrigjimin e klasifikimit të parregullt të informacionit, duke përfshirë edhe rishikimin e afatit të ruajtjes së klasifikimit si element të rëndësishëm të administrimit të informacionit të klasifikuar
3. Forcimi i mekanizmave të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar në situata emergjente, duke parashikuar procedura për shkatërrimin emergjent të informacionit të klasifikuar;
4. Përmirësimi i kuadrit ligjor për përgjegjësinë administrative në rast të shkeljes së rregullave të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar, veçanërisht në lidhje me transportimin fizik të tij;
5. Standardizimi i procedurave të mbikëqyrjes shtetërore për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, nëpërmjet përcaktimit të rregullave të qarta për kryerjen e inspektimeve që trajtojnë informacion të klasifikuar, brenda vitit 2027;
6. Rritja e nivelit të sigurisë në administrimin e informacionit të klasifikuar, përmes përmirësimit të rregullave për mbrojtjen, transportimin dhe trajtimin e tij, me synim uljen e rasteve të shkeljes së procedurave të sigurisë në institucionet që administrojnë informacion të klasifikuar.
7. Përmirësimi i procedurave të administrimit dhe përdorimit të informacionit të klasifikuar, duke qartësuar kompetencat e institucioneve për klasifikimin, deklasifikimin dhe korrigjimin e klasifikimit të parregullt të informacionit të klasifikuar, brenda vitit 2027;
8. Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me Acquis të Bashkimit Evropian dhe standardet e NATO-s, përmes harmonizimit të përkufizimeve dhe rregullave të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar me legjislacionin dhe praktikën ndërkombëtare përkatëse, brenda vitit 2026.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsioni 0 – status quo-ja Ruajtja e status quo-së dhe mosbërja e ndryshimeve ligjore. Kjo situatë nuk ka kosto financiare, por nga ana tjetër, nuk jep zgjidhje të problemeve që janë hasur gjatë kryerjes së veprimtarisë të AKSIK në proceset e punës me informacionin e klasifikuar.

Avantazhet:

- nuk ka kosto ligjore ose administrative;
- ruhet stabiliteti i rregulloreve ekzistuese;
- shmangen ndryshimet komplekse dhe nuk ka kosto implementimi.

Disavantazhe:

- Nuk adresohen problemet aktuale dhe mund të rriten kostot indirekte për përdoruesit ose autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjit ekzistues.
- Mungon zgjidhja për situata të caktuara të pazgjidhura, duke ndikuar negativisht që problemet e ligjit ekzistues mund të kenë në efektivitetin e tij ose në grupe të caktuara të prekura.

Opsioni 1 – Opsion jo-rregullator

Ky opsion parashikon adresimin e problematikave përmes mekanizmave jorregullatorë, si:

- Vetëdijësimi nëpërmjet masave informuese;
- Trajnime për të aftësuar punonjësit në proceset e punës për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar;
- Asistencë ligjore për të mundësuar zgjidhjen e problematikave.

Avantazhe:

- kosto të ulëta financiare;
- fleksibilitet në zbatim;
- rritje e ndërgjegjësimit për përgjegjësitë gjatë punës me informacionin e klasifikuar.

Disavantazhe:

- mungesë e detyrueshmërisë ligjore;
- mospërbushjen e standardeve për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

Ky opsion nuk është i mjaftueshëm për të adresuar problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të ligjit ekzistues.

Opsioni 2: – Përbën avantazh në krahasim me Opsioni 0, pasi nëpërmjet amendimit mund të rregullohen problematikat ekzistuese të ligjit aktual. Për këtë arsye opsioni 2 është opsioni i preferuar. Amendimi i ligjit ekzistues paraqet një zgjidhje të përqëndruar dhe efikase për problemet e identifikuar në ligjin aktual, duke bërë ndryshime minimale që nuk kalojnë 20% të tekstit të ligjit.

Avantazhe:

- adresim i drejtpërdrejtë i boshllëqeve ligjore dhe problematikave pa nevojën për një ligj të ri;
- proces më i shpejtë dhe më ekonomik, duke ruajtur njohjen dhe përputhshmërinë me praktikatat ekzistuese të aktorëve të përfshirë;
- përafrim i shpejtë dhe efektiv me Acquis të Bashkimit Evropian dhe politikën e sigurisë të NATO-s;
- përmirësim i praktikave të mbikëqyrjes shtetërore, nëpërmjet inspektimeve, si dhe zbatimin e masave administrative;
- kohë më e shkurtër për miratim dhe zbatim;
- përputhshmëri me parimet e teknikës legislative (ndërhyrje e pjesshme).

Disavantazhe:

- amendimi mund të krijojë konfuzion për disa aktorë që duhet të përshtaten me ndryshimet e reja;
- nuk garanton që të gjitha problemet e ligjit do të adresohen në mënyrë të plotë, veçanërisht nëse nuk identifikohen të gjitha situatat problematike.
- nevoja për përditësime të mëtejshme në të ardhmen, në funksion të zhvillimeve të Acquis dhe politikave të sigurisë të NATO-s;
- kërkesë për koordinim të lartë ndërinstitucional në zbatim.

Opsioni 3 – Ky opsion parashikon hartimin dhe miratimin e një ligji të ri për informacionin e klasifikuar, i cili do të zëvendësonte plotësisht ligjin ekzistues. Duke qenë se ndërhyrjet e nevojshme për të rregulluar problematikat janë specifikuar dhe qartësuar, si dhe nuk prekin në mënyrë thelbësore strukturën e ligjit ekzistues, ky opsion nuk konsiderohet i përshtatshëm.

Avantazhe:

- mundësi për ristrukturim të plotë të kuadrit ligjor;

- mundëson integrim të plotë dhe të drejtpërdrejtë të kërkesave Acquis dhe politikave të sigurisë së NATO-s;
- adresim gjithëpërfshirës i problematikave.

Disavantazhe:

- kosto më të larta financiare dhe administrative;
- kohë më e gjatë për hartim, konsultim dhe miratim;
- ngarkesë më e madhe për institucionet përgjegjëse;
- risk për vonesa në përmbushjen e detyrimeve të integritimit.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është Opsioni 2, i cili do të sigurojë realizimin e qëllimit për të cilin lind nevoja e ndërhyrjes në ligji aktual nr.10/2023. Gjithashtu do të garantohet zgjidhja e problematikave të konstatuara gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, nga AKSIK, institucionet e administratës publike (përfaqësitë diplomatike), operatorët ekonomik (personat fizikë dhe juridikë), të cilët për ushtrimin e detyrave të tyre dhe bazuar në parimin “nevojë për njohje”, kërkohet të kenë qasje në informacionin e klasifikuar. Përmirësimi i kuadrit ligjor për punën me informacionin e klasifikuar do të garantojë një politikë të qartë në mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, sipas standardeve të BE-së dhe NATO-s. Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional dhe e përgjegjësisë për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për informacionin e klasifikuar.

Kosto në buxhetin e shtetit: Përzgjedhja e opsionit të preferuar - opsioni 2, nuk sjell ndikime me vlerë monetare, pasi nuk parashikohet krijimi i ndonjë strukture të re dhe as i ndonjë institucioni të ri që do të shoqërohej me efekte financiare për buxhetin e shtetit. AKSIK, administrata publike dhe operatorët ekonomikë, do të zbatojnë parashikimet ligjore me burimet njerëzore ekzistuese. Rishikimet ligjore janë procese të natyrës administrative si përgatitje aktesh nënligjore dhe koordinim institucional dhe ndërinstitucional. Kryerja e trajnimeve dhe inspektimeve, realizohet nga stafi i AKSIK, në kuadër të përmbushjes së detyrave funksionale të tyre, sipas planeve vjetore të miratuara ose sipas kërkesave të veçanta të instituconeve administratës publike dhe operatorëve ekonomikë. Kostoja për zhvillimin e trajnimeve dhe inspektimeve, është e parashikuar në buxhetin e AKSIK për çdo vit kalendarik dhe nuk parashikohet të ketë kosto shtesë. Operatorët ekonomikë dhe stafi i tyre, nuk ngarkohen me kosto shtesë për realizimin e trajnimeve, për kuadrin e ri ligjor. Trajnimet kryhen në ambientet e AKSIK, ose në ambientet e institucioneve shtetërore, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, pa kosto shtesë. Edhe pse burimet ekzistuese të administratës do të mjaftojnë për zbatimin e ndryshimeve ligjore, mund të ketë kosto të pakapshme nga rritja e mundshme e ngarkesës administrative, për shkak të vështirësive në matje, apo faktorë të jashtëm që nuk mund të parashikohen., si p.sh., tejkalim i numrit të trajnimeve apo inspektimeve të planifikuara.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Inicimi i këtij projektligji lidhet me nevojën për të përditësuar kuadrin ligjor për informacionin e klasifikuar dhe për të harmonizuar e përshtatur sa më mirë me kuadrin ligjor të BE-së dhe Politikën e Sigurisë së NATO-s, si dhe synon të rregullojë problematikën, e adresuara nga institucione të ndryshme, gjatë punës me informacionin e klasifikuar. Nëpërmjet projektligjit, do të rritet niveli i përgjegjshmërisë dhe bashkëpunimit ndërinstitucional gjatë zbatimit të rregullave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Projektligji sjell ndryshime sa i përket përgjegjësisë ligjore dhe

administrative, për shkeljen e rregullave të transportimit fizik të informacionit të klasifikuar, procedurat për inspektimet, trajnimet, deklasifikimi nga një autoritet jo klasifikues, rastet e veçanta për autoritet klasifikues, shkatërrimi emergjent dhe klasifikimi i parregullt.

Ky opsion nuk sjell kosto financiare.

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsytet pse?)

Projektakti është hartuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe është dërguar në Kryeministri për bashkërendim me ministrinë dhe institucionet shtetërore. Kryeministria ka publikuar më datë 07.04.2026 në portalin e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime dhe në ligjin nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Projektakti ka qëndruar për konsultim publik deri më datë 07.05.2026. Për këtë nismë, nuk ka patur komente nga publiku në portal dhe numri i shikimeve ka qenë 312.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

AKSIK, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për hartimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave dhe standardeve të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, do të hartojë aktet nënligjore përkatëse, për njohje dhe zbatim nga institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomik, që prodhojnë apo administrojnë informacion të klasifikuar.

Monitorimi i zbatimit të këtij projektligji do të bëhet nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, përmes inspektimeve periodike apo rastësore të vazhdueshme, duke mbikëqyrur dhe monitoruar zbatimin e procedurave dhe rregullave të parashikuara për klasifikimin, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin, shkatërrimin, zbatimin e aspekteve të sigurisë fizike të informacionit të klasifikuar, sigurinë e personelit, sigurinë industriale dhe projektet e klasifikuara, sigurinë e sistemeve të komunikimit dhe informacionit. Gjithashtu, AKSIK do të zhvillojë trajnime, me qëllim edukimin e punonjësve të administratës publike, të cilët punojnë me informacionin e klasifikuar. Zbatimi i kriterëve vlerësues do të ndikojë në rritjen e efektivitetit të zbatimit të ligjit për informacionin e klasifikuar, duke ndikuar në rritjen e sigurisë dhe mbrojtjes së informacionit.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Ligji nr.10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, ka hyrë në fuqi në 09.03.2023 dhe u shoqërua me miratimin e akteve nënligjore si:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 822, Datë 26.12.2024 “Për miratimin e rregullores “Për klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret Shtetëror’ të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 823, datë 26.12.2024 “Për miratimin e rregullores “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar ‘sekret shtetëror’ të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 731, datë 27.11.2024 “Për miratimin e rregullores “për sigurinë e personelit”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurim t në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 792, datë 28.12.2023 “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për sigurinë e informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (SKI).

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 771, datë 19.12.2025 “Për procedurat për përzgjedhjen, operimin, mirëmbajtjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e materialeve kriptografike”.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 23.7.2025, “I kufizuar”, “Për procedurat për menaxhimin e sigurisë së emetimeve”.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Natyra e problemit

Ligji nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” parashikon që inspektimet në këtë fushë të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimet. Ndërkohë, kuadri i përgjithshëm ligjor për inspektimet, i rishikuar së fundmi, nuk është i përshtatur me specifikat dhe kërkesat e veçanta që lidhen me trajtimin e informacionit të klasifikuar.

Në mënyrë të veçantë, procedurat standarde të inspektimit nuk garantojnë zbatimin e plotë të parimit “nevojë për njohje”, i cili është thelbësor në administrimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Si pasojë, krijohet një boshllëk rregullator dhe praktik, ku dispozitat e përgjithshme për inspektimet nuk mund të zbatohen në mënyrë efektive pa rrezikuar cënimin e sigurisë së informacionit.

Për më tepër, mungon një akt nënligjor specifik që të rregullojë në mënyrë të detajuar procedurat, standardet dhe garancitë për kryerjen e inspektimeve në këtë fushë, duke marrë në konsideratë natyrën sensitive të informacionit.

Në këto kushte, kuadri aktual nuk siguron një balancë të duhur ndërmjet nevojës për kontroll dhe mbikëqyrje efektive dhe detyrimit për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, duke penguar realizimin e plotë të qëllimit të ligjit.

Objekt i inspektimeve është mbikëqyrja e zbatimit të masave të sigurisë që burojnë nga legjislacioni për sigurinë e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, por jo vetëm. Qëllim i tyre gjithashtu, është edhe

mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit, për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

Pikërisht për shkak të natyrës dhe objektit të tyre, inspektimet duhet të kryhen sipas rregullave dhe procedurave që ndiqen nga autoriteti përgjegjës për kontrollin, zbatimin e politikave dhe standardeve të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Gjithashtu, inspektimet, duhet të kryhen nga punonjës të pajisur me certifikatë sigurie të personelit.

Një tjetër faktor i rëndësishëm, është dhe ndjekja e detyrimeve që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare, por edhe nga ato me organizata ndërkombëtare, si NATO dhe Bashkimi Evropian. Në këtë frymë, është e domosdoshme, që procesi i inspektimeve në tërësi, të kryhet nën mbikëqyrjen e AKSIK.

Ligji ka të parashikuar si një nga detyrat kryesore zhvillimin e trajnimeve për personelin që punon me informacionin e klasifikuar, por nuk përcakton rregullat dhe procedurat që do të ndiqen për kryerjen e trajnimeve në institucionet e administratës publike dhe te operatorët ekonomikë, në lidhje me zbatimin e masave të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

Ligji nr.10/2023 përcakton “Autoritet klasifikuese” të drejtpërdrejta, që janë Presidenti i Republikës dhe Kryeministri, si dhe titullarët e institucioneve, të cilët e marrin këtë të drejtë, me autorizim të Kryeministrit, por nuk parashikon rastet e veçanta, kur titullari I institucionit nuk mund të ushtrojë këtë të drejtë.

Kuadri ligjor aktual nuk parashikon mundësinë që institucionet që nuk janë autoritete klasifikuese të deklasifikojnë informacionin e klasifikuar që ato vetë kanë prodhuar, në përgjigje të informacioneve të administruara nga institucione të tjera.

Si pasojë:

- krijohet paqartësi në kompetenca për deklasifikimin e këtij informacioni;
- institucionet nuk mund të veprojnë në mënyrë të pavarur, edhe pse janë prodhues të informacionit;
- procesi i deklasifikimit vonohet ose bllokohet, sepse duhet ndërhyrja e autoritetit klasifikues fillestar.

Ligji nr. 10/2023 nuk parashikon që, në rastet kur konstatohet klasifikim i parregullt i informacionit, të rishikohet edhe afati i ruajtjes së klasifikimit, por vetëm niveli i klasifikimit.

Pasoja e problemit

Kjo krijon disa vështirësi praktike:

- informacioni mund të ketë afat ruajtjeje të papërshtatshëm, edhe nëse ndryshohet niveli i klasifikimit;
- procedura e korrigjimit të klasifikimit mbetet e paplotë;
- mund të ketë mosadministrim të saktë të informacionit të klasifikuar.

Ligji nr. 10/2023 nuk parashikon që, në rastet kur konstatohet klasifikim i parregullt i informacionit, të rishikohet edhe afati i ruajtjes së klasifikimit, por vetëm niveli i klasifikimit.

Pasoja e problemit

Kjo krijon disa vështirësi praktike:

- informacioni mund të ketë afat ruajtjeje të papërshtatshëm, edhe nëse ndryshohet niveli i klasifikimit;
- procedura e korigjimit të klasifikimit mbetet e paplotë;
- mund të ketë mosadministrim të saktë të informacionit të klasifikuar.

Ligji aktual nuk parashikon masat e sigurisë, në rastet kur, në Përfaqësitë e RSH-së jashtë vendit, në rastet e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore dhe të emergjencave të tjera civile nuk mund të bëhet evakuimi i informacionit të klasifikuar.

Ligji aktual përdor termin “dokument” në përkufizimin e informacionit të klasifikuar, çka e kufizon fushën e mbrojtjes vetëm në dokumente dhe jo në çdo formë informacioni.

Ky përkufizim duhet të jetë në përputhje me Vendimin e Këshillit të datës 23 shtator 2013 “Mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së” (2013/488 / BE dhe Direktivën 2009/81/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datë 13 korrik 2009 “Mbi koordinimin e procedurave dhe dhënien e disa kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritetet kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë dhe që ndryshon direktivat 2004/17/KE dhe 2004/18/KE”, të ndryshuar.

Sepse:

- informacioni i klasifikuar mund të ekzistojë në forma të ndryshme; (elektronike, verbale, databaza, materiale audio-vizuale, etj.);
- termi “dokument” është më i ngushtë se termi “informacion”;
- kjo krijon mospërputhje me standardet e BE-së.

Rregullat dhe përgjegjësitë për shkeljen e procedurave të transportimit fizik të informacionit të klasifikuar nuk janë të përcaktuara mjaftueshëm në ligjin aktual.

Pasoja

Kjo mund të çojë në:

- zbatim jo të njëtrajtshëm të rregullave;
- përgjegjësi të paqarta administrative;
- rrezik për komprometimin e informacionit të klasifikuar gjatë transportit.

Problematikat e hasura gjatë zbatimit të ligjit ekzistues janë me natyrë rregullatore e cila kërkon ndërhyrjen e AKSIK për të parashikuar mangësitë ligjore për të zgjidhur natyrën e problemit.

Shkaqet e problemit

Shkaqet kryesore që janë identifikuar janë këto:

1. Kuadër ligjor i ri që nuk ka reflektuar plotësisht nevojat praktike të zbatimit

Ligji nr. 10/2023 është relativisht i ri dhe gjatë zbatimit të tij nga institucionet që punojnë me informacion të klasifikuar janë evidentuar situata praktike që nuk janë parashikuar ose janë rregulluar në mënyrë të paplotë në ligj.

Kjo ka sjellë:

- paqartësi në disa procedura administrative;
- vështirësi në zbatimin e dispozitave nga institucionet.

2. Boshllëqe në rregullimin e disa procedurave specifike

Disa procese që lidhen me administrimin e informacionit të klasifikuar nuk janë rregulluar plotësisht nga ligji aktual, si p.sh.:

- deklasifikimi i informacionit nga institucione që nuk janë autoritete klasifikuese;
- rishikimi i afatit të ruajtjes së klasifikimit kur konstatohet klasifikim i parregullt;
- trajtimi i informacionit në situata emergjente në përfaqësitë jashtë vendit;
- përgjegjësia për shkeljen e rregullave të transportimit fizik të informacionit të klasifikuar.

3. Përdorimi i disa përkufizimeve të kufizuara në ligjin aktual

Ligji aktual përdor termin “dokument”, i cili është më i kufizuar dhe nuk përfshin të gjitha format e informacionit të klasifikuar (p.sh. informacion elektronik, databaza, komunikime etj.).

Kjo krijon:

- kufizim në interpretimin e ligjit;
- nevojë për përditësim të terminologjisë.

4. Mospërputhje e pjesshme me standardet dhe praktikat ndërkombëtare

Legjislacioni aktual nuk është plotësisht i harmonizuar me disa standarde të Bashkimit Evropian dhe NATO-s, veçanërisht në:

- përkufizimin e informacionit të klasifikuar;
- procedurat e mbrojtjes dhe administrimit të tij.

5. Nevoja për rregullim më të qartë të procedurave të inspektimit dhe trajnimit

Dispozitat aktuale për inspektimet nuk janë plotësisht të përshtatura për natyrën specifike të informacionit të klasifikuar dhe mund të krijojnë paqartësi në zbatimin e procedurave të kontrollit dhe mbikëqyrjes. Gjithashtu, nuk ka parashikime për detajimin e kryerjes së trajnimeve.

Mosndërrhyrja në ligjin aktual në fuqi do të sjellë:

- rrezik për komprometim të informacionit
- probleme në bashkëpunimin ndërkombëtar
- mungesë kontrolli në inspektime

Shtrirja e problemit

Nga problematikat e hasura nga zbatimi i ligjit ekzistues preken institucionet e administratës publike, të cilat prodhojnë dhe administrojnë informacion të klasifikuar, apo operatorët ekonomik gjatë procedurave për prokurimet në fushën të mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar gjatë zbatimit të kontratës. Këto problematika kanë ndikuar në mbarëvajtjen e proceseve të punës, si dhe realizimin në kohë dhe me efikasitet të legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

Një pjesë e institucioneve si AIDSSH, MM, MF, AIF, SHISH, AMP, MPB, DPPSH, ASIG etj., kanë evidentuar problematikat e hasura, gjatë zbatimit të ligjit ekzistues. Për të zgjidhur situatën e krijuar dhe përmirësuar proceset e punës, duhet që të ndërhyet në ligjin ekzistues për të parashikuar procedurat dhe rregullat ligjore konkrete.

Problematikat e hasura kanë natyrë:

- Ligjore dhe rregullatore;
- Të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional dhe administrativ;

- Teknike, që lidhen me nevojën për plotësimin e mangësive në kuadrin aktual ligjor dhe përcaktimin e qartë të procedurave që duhet të ndiqen për trajtimin e problematikave të evidentuara.

Grupet e prekura janë:

- **Institucionet e administratës publike** që prodhojnë, administrojnë ose trajtojnë informacion të klasifikuar, të cilat në ushtrimin e funksioneve të tyre mund të kenë qasje në informacion të klasifikuar,
- **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK)**, si institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit,
- **Përfaqësitë diplomatike të RSH jashtë vendit**, që preken nga dispozitat për evakuimin/shkatërrimin emergjent,
- **Personat fizikë dhe juridikë** që, për shkak të funksioneve ose detyrave të tyre dhe në përputhje me parimin “nevojë për njohje”, mund të kenë qasje në informacion të klasifikuar.

Problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave

Nevojitet ndërhyrja e qeverisë për trajtimin dhe ndryshimin e politikave, në mënyrë që të adresohen problematikat e listuara më lart dhe kjo do të ishte në funksion të rritjes së standardeve të sigurisë, si dhe integritit të termave të përcaktuara në Dokumentin e Politikës së Sigurisë të NATO-s dhe politikën e BE-së për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Arsyet e ndërhyrjes së qeverisë dhe nevojshmëria.

Nevojitet ndërhyrja e qeverisë, në mënyrë që të realizohen prioritetet e programit të qeverisë për të përmbushur standardet për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar në përputhje me Dokumentin e Politikës së Sigurisë të NATO-s, si dhe rëndësisë për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së.

Qeveria e konsideron të domosdoshme ndërhyrjen në ligjin ekzistues për shkak të disa faktorëve thelbësorë:

Së pari, nevoja për përmbushjen e detyrimeve strategjike dhe ndërkombëtare, në veçanti përafrimin me standardet e NATO-s dhe të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së informacionit të klasifikuar. Kjo lidhet drejtpërdrejt me procesin e integritit evropian dhe forcimin e sigurisë kombëtare.

Së dyti, ekzistenca e boshllëqeve dhe paqartësive në ligjin aktual nr. 10/2023, të evidentuara gjatë zbatimit të tij në praktikë. Këto përfshijnë mungesën e rregullimit të qartë për:

- deklasifikimin nga institucione pa autoritet klasifikues,
- procedurat e shkatërrimit emergjent në përfaqësitë diplomatike jashtë vendit,
- procedurat e detajuara të inspektimit,
- si dhe mungesën e një kuadri të plotë për trajnimin në këtë fushë.

Së treti, ndryshimet në legjislacionin për inspektimet kanë krijuar një mospërputhje me ligjin ekzistues, duke e bërë të nevojshme përshtatjen e tij për të siguruar zbatueshmëri dhe koherencë ligjore.

Së katërti, gjatë zbatimit të ligjit janë hasur problematika praktike në proceset e administrimit të informacionit të klasifikuar, si:

- përcaktimi i afatit të ruajtjes së klasifikimit,
- përkufizimi i informacionit si “informacion” dhe jo vetëm “dokument”,
- zgjerimi i nocionit të autoritetit klasifikues,
- qartësimi i përgjegjësive për transportin fizik.

Së fundi, mungesa e akteve nënligjore përkatëse (veçanërisht për procedurat e inspektimit) ka penguar edhe zbatimin e masave administrative, duke krijuar nevojën për plotësimin e këtij kuadri.

Çfarë synon të trajtojë qeveria nëpërmjet ndërhyrjes

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje, qeveria synon të adresojë dhe përmirësojë disa aspekte kyçe:

Së pari, të plotësojë dhe qartësojë kuadrin ligjor ekzistues, duke eliminuar boshllëqet dhe paqartësitë që janë evidentuar gjatë zbatimit praktik të ligjit.

Së dyti, të vendosë rregulla të qarta dhe të detajuara për procese specifike, si:

- deklasifikimi i informacionit,
- shkatërrimi emergjent në përfaqësitë diplomatike,
- procedurat e inspektimit nga autoriteti përgjegjës,
- organizimi dhe zhvillimi i trajnimeve.

Së treti, të sigurojë përputhshmërinë e plotë të legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare të sigurisë, veçanërisht ato të NATO-s dhe të BE-së.

Së katërti, të përmirësojë administrimin dhe menaxhimin e informacionit të klasifikuar në administratën publike, duke rritur efikasitetin, sigurinë dhe përgjegjshmërinë institucionale.

Së pesti, të mundësojë zbatimin efektiv të mekanizmave të kontrollit dhe sanksionimit (përfshirë masat administrative), përmes miratimit të akteve nënligjore përkatëse.

Në tërësi, ndërhyrja synon forcimin e sistemit të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar, rritjen e standardeve të sigurisë dhe përmbushjen e objektivave strategjike të qeverisë, në kuadër të integritetit evropian.

Si mbështetet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë

Kjo nismë përmbush objektivat e programit të qeverisë, nëpërmjet dokumenteve strategjike, si:

1.Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Shqipërisë për periudhën 2023-2028

Ligji i AKSIK është i harmonizuar me dokumente si Strategjia e Sigurisë Kombëtare, ku mbrojtja e informacionit të klasifikuar është element kyç i sigurisë kombëtare. AKSIK është institucioni që garanton zbatimin praktik të këtyre objektivave.

2. Kuadri i integritetit evropian (BE/NATO)

Ky ligj lidhet ngushtë me detyrimet që Shqipëria ka në kuadër të:

- NATO (sidomos për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të NATO-s);
- procesit të integritetit në Bashkimi Evropian.

Në këtë kontekst, ligji reflekton standardet ndërkombëtare për:

- sigurinë e informacionit;
- shkëmbimin e informacionit të klasifikuar;
- besueshmërinë institucionale.

3. Politikat për sigurinë kibernetike dhe informacionin

Ajo lidhet edhe me strategji si:

- **Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030 dhe Planin e Veprimit për periudhën 2025–2027**

Nëpërmjet rishikimit të ligjit ekzsitues, synohet që të realizohen objektiva më të gjera të qeverisë lidhur me forcimin e sigurisë kombëtare, rritjen e standardit të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar, përmbushjen e detyrimeve në procesin e integritetit evropian, përmirësimin e administrimit të informacionit të klasifikuar në administratën publike.

Mbrojtja e informacionit të klasifikuar nga humbja, dëmtimi, rrjedhja, kompromentimi ose ekspozimi i paautorizuar është një nga prioritetet e AKSIK me qëllim përmbushjen e misionit dhe detyrave të tij.

Puna ekzistuese e AKSIK:

AKSIK pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.10/2023, ka rishikuar kuadrin ligjor, duke nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të ligjit, sipas disiplinave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar e konkretisht, siguria e informacionit, siguria e personelit, siguria fizike, siguria e sistemeve të komunikimit dhe informacionit, si dhe projekte të klasifikuara dhe siguria industriale.

Për secilën disiplinë, janë miratuar edhe VKM-të përkatëse në formën e rregulloreve, për: klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin, sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” të Nato-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare; sigurinë e personelit; për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për sigurinë e informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (SKI); për procedurat për përzgjedhjen, operimin, mirëmbajtjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e materialeve kriptografike, si dhe për procedurat për menaxhimin e sigurisë së emetimeve”.

Gjithashtu janë nxjerrë udhëzime lidhur me intervistat e sigurisë, në kuadër të procesit të verifikimit të sigurisë për individët, të cilët pajisen me Certifikatë Sigurie të Personelit; udhëzim për modelet e shkresave të klasifikuara, modelet e regjistrave për administrimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, të NATO-s, të BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, si dhe modele orinetuese të praktikave për “autoritet klasifikues”, klasifikimin, deklasifikimin dhe zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar; udhëzim për zbatimin e procedurave të shkatërrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe të BE-së; udhëzim mbi auditimin e sigurisë së sistemeve të komunikimit dhe informacionit, ku trajtohet informacion i klasifikuar “sekret shtetëror”; udhëzim për procedurat e dezinfektimit elektronik, aspektet e sigurisë fizike të informacionit të klasifikuar si dhe modelet orientuese të praktikave për ndarjen e zonave të sigurisë, strukturën e sigurisë; modelet e dokumenteve për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmbajnë informacion të klasifikuar.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë realizuar rreth 200 inspektime dhe 60 trajnime. Për të eliminuar problematikat e hasura gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, AKSIK ka dhënë asistencë ligjore dhe rekomandime për institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomik, për të realizuar proceset e punës me informacionin e klasifikuar, referuar problematikave të listuara më lart. Vendosja e masave administrative me gjobë, nuk është zbatuar, pasi mungon akti nënligjor, që rregullon procedurat e detajuara për inspektimet. Ky akt do të nxirret, pas miratimit të ndryshimeve të propozuara në projektligj. Gjithashtu,

arsyet e ndërhyrjes lidhen edhe me nevojën për të rregulluar kuadrin ligjor për kryerjen e trajnimeve në fushën e informacionit të klasifikuar.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat e politikës, që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij janë:

1. Qartësimi i kompetencave për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar, për institucionet që prodhojnë informacion të klasifikuar brenda vitit 2026;
2. Përmirësimi i mekanizmave për korrigjimin e klasifikimit të parregullt të informacionit, duke përfshirë edhe rishikimin e afatit të ruajtjes së klasifikimit si element të rëndësishëm të administrimit të informacionit të klasifikuar;
3. Forcimi i mekanizmave të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar në situata emergjente, duke parashikuar procedura për shkatërrimin emergjent të informacionit të klasifikuar;
4. Përmirësimi i kuadrit ligjor për përgjegjësinë administrative në rast të shkeljes së rregullave të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar, veçanërisht në lidhje me transportimin fizik të tij;
5. Standardizimi i procedurave të mbikëqyrjes shtetërore për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, nëpërmjet përcaktimit të rregullave të qarta për kryerjen e inspektimeve që trajtojnë informacion të klasifikuar, brenda vitit 2027;
6. Rritja e nivelit të sigurisë në administrimin e informacionit të klasifikuar, përmes përmirësimit të rregullave për mbrojtjen, transportimin dhe trajtimin e tij, me synim uljen e rasteve të shkeljes së procedurave të sigurisë në institucionet që administrojnë informacion të klasifikuar;
7. Përmirësimi i procedurave të administrimit dhe përdorimit të informacionit të klasifikuar, duke qartësuar kompetencat e institucioneve për klasifikimin, deklasifikimin dhe korrigjimin e klasifikimit të parregullt të informacionit të klasifikuar, brenda vitit 2027;
8. Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me Acquis të Bashkimit Evropian dhe standardet e NATO-s, përmes harmonizimit të përkufizimeve dhe rregullave të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar me legjislacionin dhe praktikat ndërkombëtare përkatëse, brenda vitit 2026.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsioni 0 – *status quo-ja* Ruajtja e *status quo-së* dhe mosbërja e ndryshimeve ligjore. Kjo situatë nuk ka kosto financiare, por nga ana tjetër, nuk jep zgjidhje të problemeve që janë hasur gjatë kryerjes së veprimtarisë të AKSIK në proceset e punës me informacionin e klasifikuar.

Avantazhet:

- nuk ka kosto ligjore ose administrative;
- ruhet stabiliteti i rregulloreve ekzistuese,
- shmangen ndryshimet komplekse dhe nuk ka kosto implementimi.

Disavantazhe:

- Nuk adresohen problemet aktuale dhe mund të rriten kostot indirekte për përdoruesit ose autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjit ekzistues.

- Mungon zgjidhja për situata të caktuara të pazgjidhura, duke ndikuar negativisht që problemet e ligjit ekzistues mund të kenë në efektivitetin e tij ose në grupe të caktuara të prekura.

Opsioni 1 – Opsion jo-rregullator

Ky opsion parashikon adresimin e problematikave përmes mekanizmave jorregullatorë, si:

- Vetëdijësimi nëpërmjet masave informuese;
- Trajnime për të aftësuar punonjësit në proceset e punës për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar;
- Asistencë ligjore për të mundësuar zgjidhjen e problematikave.

Avantazhe:

- kosto të ulëta financiare;
- fleksibilitet në zbatim;
- rritje e ndërgjegjësimit për përgjegjësitë gjatë punës me informacionin e klasifikuar.

Disavantazhe:

- mungesë e detyrueshmërisë ligjore;
- mospërbushjen e standardeve për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

Ky opsion nuk është i mjaftueshëm për të adresuar problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të ligjit ekzistues.

Opsioni 2: – Përbën avantazh në krahasim me Opsioni 0, pasi nëpërmjet amendimit mund të rregullohen problematikat ekzistuese të ligjit aktual. Për këtë arsye opsioni 2 është opsioni i preferuar. Amendimi i ligjit ekzistues paraqet një zgjidhje të përqëndruar dhe efikase për problemet e identifikuara në ligjin aktual, duke bërë ndryshime minimale që nuk kalojnë 20% të tekstit të ligjit.

Avantazhe:

- adresim i drejtpërdrejtë i boshllëqeve ligjore dhe problematikave pa nevojën për një ligj të ri;
- proces më i shpejtë dhe më ekonomik, duke ruajtur njohjen dhe përputhshmërinë me praktikën ekzistuese të aktorëve të përfshirë;
- përafrim i shpejtë dhe efektiv me Acquis të Bashkimit Evropian dhe politikën e sigurisë të NATO-s;
- përmirësim i praktikave të mbikëqyrjes shtetërore, nëpërmjet inspektimeve, si dhe zbatimin e masave administrative;
- kohë më e shkurtër për miratim dhe zbatim;
- përputhshmëri me parimet e teknikës legjislative (ndërhyrje e pjesshme).

Disavantazhe:

- amendimi mund të krijojë konfuzion për disa aktorë që duhet të përshtaten me ndryshimet e reja;
- nuk garanton që të gjitha problemet e ligjit do të adresohen në mënyrë të plotë, veçanërisht nëse nuk identifikohen të gjitha situatat problematike.
- nevoja për përditësime të mëtejshme në të ardhmen, në funksion të zhvillimeve të Acquis dhe politikave të sigurisë të NATO-s;
- kërkesë për koordinim të lartë ndër-institucional në zbatim.

Opsioni 3 – Ky opsion parashikon hartimin dhe miratimin e një ligji të ri për informacionin e klasifikuar, i cili do të zëvendësonte plotësisht ligjin ekzistues. Duke qenë se ndërhyrjet e nevojshme për të rregulluar problematikat janë specifikuar dhe qartësuar, si dhe nuk prekin në mënyrë thelbësore strukturën e ligjit ekzistues, ky opsion nuk konsiderohet i përshtatshëm.

Avantazhe:

- mundësi për ristrukturim të plotë të kuadrit ligjor;
- mundëson integrim të plotë dhe të drejtpërdrejtë të kërkesave Acquis dhe politikave të sigurisë së

NATO-s;

- adresim gjithëpërfshirës i problematikave.

Disavantazhe:

- kosto më të larta financiare dhe administrative;
- kohë më e gjatë për hartim, konsultim dhe miratim;
- ngarkesë më e madhe për institucionet përgjegjëse;
- risk për vonesa në përmbushjen e detyrimeve të integritetit

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasimore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Grupet e prekura janë:

- **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK)**, si institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit;
- **Institucionet e administratës publike** (ministrinë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, administratën e prefektit, institucionet e pavarura, gjykatat, prokuroritë e çdo juridiksioni, Byroja Kombëtare të Hetimit, si dhe organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, që prodhojnë, administrojnë ose trajtojnë informacion të klasifikuar, të cilat në ushtrimin e funksioneve të tyre mund të kenë qasje në informacion të klasifikuar;
- **Përfaqësitë diplomatike jashtë vendit**, që preken nga dispozitat për evakuimin/shkatërrimin emergjent;
- **Personat fizikë dhe juridikë** që, për shkak të funksioneve ose detyrave të tyre dhe në përputhje me parimin “nevojë për njohje”, mund të kenë qasje në informacion të klasifikuar;
- **Qyterarët;**
- **Qeveria.**

AKSIK

1. AKSIK (Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar)

Ndikime administrative

- **Pozitive (direkte):**
 - Përmirësim i kuadrit rregullator përmes procedurave të detajuara për inspektimet dhe trajnimet;
 - Rritje e efektivitetit në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës dhe kontrollues;
 - Mundësim i zbatimit të masave administrative (gjobave), që më parë ishte i pamundur për shkak të mungesës së akteve nënligjore.
- **Pozitive (indirekte):**
 - Rritje e kapaciteteve institucionale dhe profesionalizmit;
 - Forcimi i koordinimit ndër-institucional.

Ndikime institucionale / qeverisëse

- Rritje e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në mbikëqyrjen e sistemit të sigurisë së informacionit;
- Forcimi i rolit si autoritet qendror në këtë fushë.

Ndikime financiare minimale:

- Nuk krijohen struktura të reja;
- Kosto të kufizuara operacionale (trajnime, inspektime), të përballueshme me burimet ekzistuese.

2. Grupet e tjera të interesit administrata publike (përfaqësitë diplomatike jashtë vendit), personat fizik dhe juridikë:

Ndikime administrative

- **Pozitive (direkte):**
 - Zgjidhje e problematikave për punën me informacionin e klasifikuar sipas standardeve të parashikuara në legjislacion;
 - Zbatim i detyrimeve për krijimin e kushteve të nevojshme për kryerjen e inspektimeve;
 - Aftësim dhe edukim të personelit që punon me informacionin e klasifikuar nëpërmjet trajnimit.
- **Pozitive (indirekte):**
 - Forcimi i koordinimit ndër-institucional;
 - Rritje e kapaciteteve institucionale dhe profesionalizmit.
- **Ndikime institucionale /qeverisëse**
 - Rritje e ndërgjegjësimit dhe përgjegjshmërisë për zbatimin e detyrave gjatë zbatimit të legjislacionit për informacionin e klasifikuar.
- **Ndikime financiare minimale:**
 - Nuk krijohen struktura të reja;
 - Nuk ka kosto për buxhetin.

3. Qytetarët

Ndikime të drejtëpërdrejta:

- Nuk ka.

Ndikime të jodrejtëpërdrejta:

Përmirësimi i kuadrit ligjor për punën me informacionin e klasifikuar ndikon në rritjen e sigurisë kombëtare gjë e cila sjell ndikim pozitiv indirekt për qytetarët si:

- Ndikim social, duke rritur sigurinë e jetës dhe mirëqenies së qytetarëve.

4. Qeveria

Ndikime administrative

- **Pozitive (direkte):**

- Përmbushja e detyrimeve në kuadër të përafrimit të legjislacionit me Acquis e BE-së dhe forcimin e pozicionit të Shqipërisë në procesin e integritit evropian;
- Projektligji rrit standardet e sigurisë për informacionin e klasifikuar, çka do të thotë që ndikon pozitivisht në sigurinë kombëtare dhe interesin publik;
- Kontributi i drejtëpërdrejtë në sigurinë e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, duke rritur besueshmërinë në arenën ndërkombëtare të Shqipërisë me partnerët apo organizatat ndërkombëtare.

- **Pozitive (indirekte):**

- Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional ;
- Rritja e përgjegjësisë për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për informacionin e klasifikuar.

- **Ndikime institucionale /qeverisëse**

- Rritje e përgjegjshmërisë për zbatimin e standarteve për sigurinë e informacionit të klasifikuar;
- Forcimi i rolit në fushën e sigurisë së informacionit të klasifikuar.

Ndikime financiare minimale:

- Nuk krijohen struktura të reja;
- Nuk ka kosto për buxhetin.

Kufizimi i analizës

Mosmiratimi i ndryshimeve ligjore të propozuara në projektligj do të sillte si risk:

- Ndikimin e drejtëpërdrejtë në ligjshmërinë materiale të aktit ekzistues, pasi nuk zgjidhen problematikat e identifikuara gjatë punës me informacionin e klasifikuar;
- Ndikim në vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e aktit ekzistues,
- Cënim të transparencës dhe llogaridhënies në vendimmarrjen publike;
- Ndërgjegjësimin dhe rritjen e përgjegjësisë së personelit gjatë punës me informacionin e klasifikuar;
- Mosaplikim i masave administrative në ligjin ekzistues.

Mos miratimi në kohë i ndryshimeve të propozuara do të pengonte realizimin e përfitimeve duke sjellë pasoja negative në:

- Zbatimin e standardeve ligjore për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, në përmbushje të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Zgjidhjen e problematikave të identifikuara, duke mosrregulluar dobësitë apo mangësitë ligjore gjatë punës me informacionin e klasifikuar;
- Zbatimin joefektiv të aktit ekzistues dhe potencialisht në përgjegjësi institucionale;
- Nevojës për trajnime që lidhet me efikasitetin e administratës publike gjatë punës me informacionin e klasifikuar;
- Vonesave në zbatimin e ndryshimeve ligjore;
- Mosnxjerrja e akteve nënligjore, udhëzimeve dhe modeleve orintuese për procedurat e punës me informacionin e klasifikuar.

Gjithashtu, do të pengojë AKSIK si autoritet përgjegjës për hartimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave dhe standardeve të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO-s, të BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, në përmbushjen e detyrave dhe misionit të tij.

Kosto në buxhetin e shtetit:

Në projektligj nuk parashikohet krijimi i ndonjë strukture të re dhe as i ndonjë institucioni të ri, gjë që do të shoqërohej me efekte financiare për buxhetin e shtetit. AKSIK, administrata publike dhe operatorët ekonomikë, do të zbatojnë parashikimet ligjore me burimet njerëzore ekzistuese.

Rishikimet ligjore janë procese të natyrës administrative si përgatitje aktesh nënligjore dhe koordinim institucional dhe ndërinstitutional.

Kryerja e trajnimeve dhe inspektimeve, realizohet nga stafi i AKSIK, në kuadër të përmbushjes së detyrave funksionale të tyre, sipas planeve vjetore të miratuara ose sipas kërkesave të veçanta të instituconeve administratës publike dhe operatorëve ekonomikë. Kostoja për zhvillimin e trajnimeve dhe inspektimeve, është e parashikuar në buxhetin e AKSIK për çdo vit kalendarik dhe nuk parashikohet të ketë kosto shtesë. Operatorët ekonomikë dhe stafi i tyre, nuk ngarkohen me kosto shtesë për realizimin e trajnimeve, për kuadrin e ri ligjor.

Trajnimet kryhen në ambientet e AKSIK, ose në ambientet e institucioneve shtetërore, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional, pa kosto shtesë.

Edhe pse burimet ekzistuese të administratës do të mjaftojnë për zbatimin e ndryshimeve ligjore, mund të ketë kosto të pakapshme nga rritja e mundshme të ngarkesës administrative, për shkak të vështirësive në matje, apo faktorë të jashtëm që nuk mund të parashikohen., si p.sh., tejkalim i numrit të trajnimeve apo inspektimeve të planifikuara.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është: Opsioni i preferuar është përzgjedhur opsioni 2, Amendimi (ndryshimi) i ligjit ekzistues (nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”).

Inicimi i këtij projektligji lidhet me nevojën për të përditësuar kuadrin ligjor për informacionin e klasifikuar, si dhe për të harmonizuar e përshtatur sa më mirë me kuadrin ligjor të BE-së dhe Politikën e Sigurisë së NATO-s .

Ky projektligj, gjithashtu synon të rregullojë problematikat, e adresuara nga institucione të ndryshme, gjatë punës me informacionin e klasifikuar, mbi deklasifikimin e informacionit të klasifikuar nga institucionet që nuk kanë autoritet klasifikues.

Kjo, do të ndihmojë në procedurat e deklasifikimit, për rastet kur institucionet e përmendura në rastin përjashtimor dhe që nuk janë autoritet klasifikues, vlerësojnë se informacioni i klasifikuar, *i prodhuar nga vetë ato*, duhet t’i nënshtrohet deklasifikimit.

Gjithashtu, synohet që të rregullohet mangësia ligjore, për rastet e veçanta dhe me afat të kufizuar, për “autoritet klasifikues” kur titullari i institucionit nuk mund të ushtrojë këtë të drejtë. Në këto raste, këtë të drejtë mund ta ushtrojë një funksionar i lartë i një institucioni që prodhon informacionin e klasifikuar.

Një tjetër propozim, i cili do të ndikojë në rritjen e masave të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, është propozimi për raset kur, në pamundësi të evakuimit të informacionit të klasifikuar, Përfaqësitë e RSH-së jashtë vendit, mund të bëjnë shkatërrimin emergjent të informacionit të klasifikuar, në rastet e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore dhe të emergjencave të tjera civile.

Projektligji synon të rregullojë këtë problematikë, duke parashikuar se, në këto raste, me urdhër të titullarit të Përfaqësisë, mund të bëhet shkatërrimi emergjent i informacionit të klasifikuar.

Nëpërmjet projektligjit, do të rritet niveli i përgjegjshmërisë gjatë zbatimit të rregullave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Projektligji sjell ndryshime sa i përket përgjegjësisë ligjore dhe administrative, për shkeljen e rregullave të transportimit fizik të informacionit të klasifikuar.

Në kuadër të përafrimit të mëtjeshëm të legjislacionit shqiptar për informacionin e klasifikuar me Acquis të BE-së, propozohet ndryshimi i përkufizimit të “informacionit të klasifikuar”.

Në frymën e detyrimeve ndërkombëtare, projektligji është realizuar duke u mbështetur në:

- Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian të 23 shtatorit 2013 “Për rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar” 2013/488/BE, i ndryshuar;
- Direktivën 2009/81/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009 “Mbi koordinimin e procedurave dhe dhënien e kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritetet kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë dhe që ndryshon direktivat 2004/17/KE dhe 2004/18/KE”, të ndryshuar.

Ndryshimi i ligjit ekzistues, përbën avantazh dhe sjell si risi:

Formalizimin dhe standardizimin e procedurave të kryerjes së inspektiveve.

Të drejtën e deklasifikimit të informacionit të klasifikuar nga institucione të cilat nuk janë autoritetet klasifikues, por që prodhojnë një informacion të klasifikuar, në përgjigje të informacioneve të administruara nga institucione të tjera.

Shkatërrimin emergjent të informacionit të klasifikuar në Përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë, jashtë vendit, në rastet e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera civile, në pamundësi të evakuimit të informacionit të klasifikuar.

Opsionet që janë marrë në konsideratë për analizën me shumë kritere janë:

Opsioni 0: – Ruajtja e status quo-së, të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues ;

Opsioni 1 – Opsioni jorregullator Opsioni 2: – Amendimi (ndryshimi) i ligjit aktual (nr. 10/2023, datë 02.02.2023 “Për informacionin e klasifikuar”)

Opsioni 3:- Shfuqizimi i ligjit aktual dhe hartimi i një ligji të ri .

Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kritere, janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

Janë përcaktuar kriteret që tregojnë arritjen e objektivave:

1. Adresim i drejtpërdrejtë dhe shpejtë i boshllëqeve ligjore dhe zgjidhjen e problematikave;
2. Efikasiteti i standardeve të sigurisë në mbrotjen e informacionit të klasifikuar;
3. Harmonizimi i ligjit me Acquis të Bashkimit Evropian dhe politikën e sigurisë të NATO-s;
4. Efikasiteti i standardizimit të procedurave të inspektimit;
5. Kosto – efektiviteti.

Është vendosur pesha e kriterëve sipas rëndësisë relative:

1. Adresim i drejtpërdrejtë dhe shpejtë i boshllëqeve ligjore dhe zgjidhjen e problematikave; - 4
2. Efikasiteti i standardeve të sigurisë në mbrotjen e informacionit të klasifikuar; - 4.
3. Harmonizimi i ligjit me Acquis të Bashkimit Evropian dhe politikën e sigurisë të NATO-s; - 3
4. Efikasiteti i standardizimit të procedurave të inspektimit; - 4
5. Kosto – efektiviteti; – 5

Pra, për të bërë dallimin e opsioneve nga njëra-tjetra dhe me qëllim përzgjedhjen e opsionit më të mirë secili kriter është vlerësuar me një peshë specifike vlerësuar nga 1-5;

Gjithashtu, secili kriter në varësi të peshës së tij, është vlerësuar me pikë përkatëse sipas shkallës së preferencës për çdo opsion për secilin kriter nga 0-5 ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

<i>Kriteret</i>	<i>Pesha</i>	<i>Opsioni 0</i>	<i>Opsioni 1</i>	<i>Opsioni 2</i>	<i>Opsioni 3</i>
Adresim i drejtpërdrejtë dhe shpejtë i boshllëqeve ligjore dhe zgjidhjen e problematikave	4	0 (0)	1 (4)	4 (16)	4 (16)
Efikasiteti i standardeve të sigurisë në mbrotjen e informacionit të klasifikuar.	4	3 (12)	1 (4)	4 (16)	4 (16)
Harmonizimi i ligjit me Acquis të Bashkimit Evropian dhe politikën e sigurisë të NATO-s.	3	2 (6)	1 (3)	3 (9)	3 (9)
Efikasiteti i standardizimit të procedurave të inspektimit	4	0 (0)	2 (8)	5 (20)	3 (15)
Kosto-efektiviteti	5	1 (5)	2 (10)	5 (25)	2 (10)
Total (pikët)		23	29	86	66

Opsioni 2 – 86 pikë më i larti në pikëzim.

Bazuar në analizën me shumë kriterë Opsioni 2, rezulton si opsioni më i mirë i mundshëm, pasi:

- siguron përmbushjen e objektivave të politikës;
- është me kosto-efektive;

- garanton përafrimin me Acquis të BE dhe Politikën e Sigurisë së NATO;
- mundëson zbatim të shpejtë dhe efektiv;

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Pas hyrjes në fuqi të projektligjit:

Strukturë përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e projektligjit është AKSIK, i cili do të hartojë aktet nënligjore për zbatimin e këtij projektligji, brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi të tij. Aktet nënligjore që do të hartohen janë Vendime të Këshillit të Ministrave, që do të përcaktojnë:

1. Rregullat dhe procedurat për kryerjen e trajnimeve që AKSIK zhvillon, për personelin që punon me informacion të klasifikuar.
2. Rregullat e detajuara për kryerjen e procedurave të inspektimeve, ankimeve, shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimit të tyre. Ky akt nënligjor rregullon kuadrin ligjor për inspektimet, si dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e institucioneve dhe personelit që punon me informacionin e klasifikuar, në rastet e vendosjes nga AKSIK, të masave administrative. Akte të tjera nënligjore në fuqi që do të reflektojnë ndryshimet e ligjit për informacionin e klasifikuar, për “autoritetet klasifikues”, për masat e sigurisë nga Përfaqësitë diplomatike të RSH-së jashtë vendit, në rastet gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore dhe të emergjencave të tjera civile për evakuimin e informacionit të klasifikuar dhe për deklasifikimin.

Për zbatimin e opsionit të preferuar do të ngarkohen institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë, të cilët duhet të marrin masa për zbatimin e kërkesave të projektligjit dhe akteve nënligjore, që prodhojnë apo administrojnë informacion të klasifikuar. Masat janë të tilla mund të jenë si krijimi, regjistrimi, qarkullimi, shfrytëzimi, shumëfishimi, transportimi, transmetimi, ruajtja, arkivimi, asgjësimi dhe shkatërrimi i informacionit të klasifikuar, marrja e masave për sigurinë e personelit, sigurinë fizike të informacionit të klasifikuar, sigurinë e sistemeve të komunikimit dhe informacionit, si dhe sigunë industriale dhe projektet e klasifikuara

ASKIK do të ndërmarrë masa për zbatimin e opsionit të preferuar nëpërmjet realizimit të inspektimeve në institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë, duke vendosur dhe ekzekutuar masat administrative (nenet 75 – 77 të ligjit nr. 10/2023).

Masa të tjera për zbatimin efektiv:

- forcimi i kapaciteteve institucionale për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për informacionin e klasifikuar ;
- rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional dhe ndërinstitutional;
- trajnime dhe asistencë të vazhdueshme për strukturat përgjegjëse, institucionet e administratës publike dhe opererorët ekonomikë.

Pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur

Pengesat e mundshme mund të lidhen me mundësinë e hartimit dhe miratimit ose jo brenda afateve, të akteve nënligjore në zbatim të ndryshimeve që do të miratohen me këtë projektligj.

Një pengesë e mundshme për zbatimin e opsionit të preferuar mund të jetë miratimi i udhëzimeve apo modeleve orientuese për proceset e punës me informacionin e klasifikuar nga AKSIK, në zbatim të akteve nënligjore të cilat do të ndryshohen pas hyrjes në fuqi akteve.

Pengesat e mundshme për zbatimin:

- kapacitete të kufizuara të burimeve njerëzore;
- koordinim i pamjaftueshëm ndërinstucional;
- mungesë koordinimit dhe bashkëpunimi ndërmjet sektorëve.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi i zbatimit të këtij projektligji do të bëhet nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, përmes inspektimeve periodike apo rastësore të vazhdueshme, duke mbikëqyrur dhe monitoruar zbatimin e procedurave dhe rregullave të parashikuara për klasifikimin, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin, shkatërrimin, zbatimin e aspekteve të sigurisë fizike të informacionit të klasifikuar, sigurinë e personelit, sigurinë industriale dhe projektet e klasifikuara, sigurinë e sistemeve të komunikimit dhe informacionit. Gjithashtu, AKSIK do të zhvillojë trajnime, me qëllim edukimin e punonjësve të administratës publike, të cilët punojnë me informacionin e klasifikuar.

Për monitorimin e zbatimit të projektligjit do të shërbejnë raportet e inspektimit të hartuara nga trupa e inspektimit e caktuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKSIK duke evidentuar arritjet, mangësitë, rekomandimet dhe masat administrative përkatëse, afatet, përmirësimin e mangësive dhe masat e marra ndaj personave që kanë shkelur rregullat e sigurisë, në institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomik, që janë objekt inspektimi. Këto të dhëna hartohen mbi bazën programit të inspektimit që dërgohet nga AKSIK, tek subjektet e inspektimit përpara realizimit të inspektimit, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi për informacionin e klasifikuar.

Kritere të tjera treguese për të matur arritjen e objektivave ose progresin e tyre janë:

- a. Efektiviteti i mbrojtjes së informacionit të klasifikuar – p.sh., numri i incidenteve të sigurisë para dhe pas hyrjes në fuqi të ligjit;
- b. Rritja e njohurive dhe aftësive të stafit – matet përmes trajnimeve të kryera, certifikimeve të marra dhe testeve të performancës;
- c. Përmirësimi i koordinimit ndërinstucional – matet përmes sondazheve ose vlerësimeve cilësore se si institucionet bashkëpunojnë për të mbrojtur informacionin;
- d. Koha e reagimit ndaj shkeljeve – sa shpejt institucioni merr masa pas një shkeljeje, që tregon efikasitetin e ligjit;
- e. Reduktimi i rreziqeve reale për informacionin e klasifikuar – një tregues kryesor i efektivitetit, i cili mund të matet përmes auditimeve të jashtme ose vlerësimeve të riskut.

Zbatimi i këtyre kriterëve do të ndikojë në rritjen e efektivitetit të zbatimit të ligjit për informacionin e klasifikuar, duke ndikuar në rritjen e sigurisë dhe mbrojtjes së informacionit.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin - një herë										
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										
Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
Kosto në total										
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës										
Përfitimet për buxhetin – një herë										
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi										
Përfitimet për grupet e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin – një herë										
Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi										
Përfitimet totale										
Përfitimi i zbritur= Përfitimi										

në total x faktori zbritës										
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total										
Vlera prezente aktuale e kostos në total										
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0